



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 991/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbarimore të kreditorit Ballkan Trade Sh.p.k, me nr. të biznesit 810971342, me seli në Prizren, rr. “Selver Maçkaj”, nr.8, e cilas sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat V. O. nga Prizreni, kundër debitorit “Arbri D” Sh.p.k, me nr. të biznesit 811331347, me seli në Lipjan, Gadime e Epërme, rr. “Musli Ademi” p.n, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat A. H. nga Lipjani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 1375/21 të datës 27.09.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Rushit Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës me datë 30.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit “Arbri D” Sh.p.k. ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr. 1375/21 i datës 27.09.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha sa i përket borxhit në shumën prej 391.92 EUR.
- II. REFUZHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit “Arbri D” Sh.p.k. ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarimor P.nr. 1375/21 të datës 27.09.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha sa i përket borxhit në vlerë prej 1,780.98 EUR.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me datë 27.09.2021 ka lëshuar Urdhër Përmbarimor P.nr. 1375/21, me të cilin ka lejuar përmbarimin mbi bazën e dokumenteve:

faturë nr. 1048/AD e datës 16.11.2020, fletëpranim e datës 16.11.2020 dhe faturë nr. 608/AB e datës 11.06.2020 duke urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit të papaguar nga faturat e lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën e prej 2,172.90 EUR (dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy euro, e nëntëdhjetë euro cent) me kamatë ligjore nga dita e dorëzimit të propozimit për përmbarim si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore për aq sa do të krijohen në këtë procedurë përmbarimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim përmes të cilit ka kontestuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarimit me arsyetimin se fatura nr. 608/AD e datës 11.06.2020 nuk paraqet dokument të besueshëm pasi që nuk ka provë se e njëjta është dorëzuar nga kreditori tek debitori dhe se është pranuar në ndonjë formë nga ana e debitorit, dhe njëjta nuk ka përshkrim të qartë të shërbimeve të kryera. Tutje ka shtuar se fatura e lartcekur nuk përmban kohën e përmbushjes së detyrimit monetar dhe e njëjta nuk është paraqitur në origjinal apo në kopje të vërtetuar. Me kërkesë që të aprovohet prapësimi në tërësi si i bazuar, ndërsa urdhri për lejimin e përmbarimit të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit për faktin se faturat e kreditorit janë lëshuar për mallin e pranuar nga ana e debitorit, fakt të cilin nuk e ka mohuar debitori. Ka shtuar se debitori ka bërë pagesa të kohë paskohshme për kreditorin andaj i njëjti nuk mund të thirret në mos pranimin e faturave. Andaj ka kërkuar nga ana e Gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit ndaj ndërsa urdhri për lejimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të

këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Nga të lartcekurat, Gjykata gjeti se fatura nr. 608/AB e datës 11.06.2020 në vlerë prej 2,801.98 EUR, si një nga faturat mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarrimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29, par.3 të LPP-së, ngase nuk mund të vërtetohet që e njëjta është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se është pranuar nga debitori, për arsye se të njëjës i mungon nënshkrimi apo vula e debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit faturën mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri, ndërsa ky i fundit të njëjtën e ka pranuar dhe është njoftuar me detyrimin që buron nga fatura. Andaj, fatura e lartcekur nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë përderisa rezulton të jetë lëshuar njëanshëm nga kreditori.

Tutje, Gjykata gjeti se propozimin për përmbarrim, kreditori e ka mbështetur edhe në fletëpranimin e datës 16.11.2020 në vlerë prej 1,914.64 EUR, por që e njëjta po ashtu nuk paraqet bazë për lejimin e përmbarrimit, pasi që nuk konsiderohet si faturë në kuptim të nenit 29, par.3 të LPP-së, dhe nga përshkrimi i fletëpranimit, ky dokument rezulton si kthim i shitjes, ndërsa nga vet kartela e komitentit e bashkëngjitur nga kreditori rezulton se shuma e cekur në këtë fletëpranim është zbritur nga kreditori në raport me borxhin e pretenduar ndaj debitorit.

Nga të lartcekurat, Gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, duke shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbarrimit sa i përket faturës nr. 608/AB e datës 11.06.2020 dhe fletëpranimit të datës 16.11.2020, në vlerë prej 391.92 EUR, pasi kjo shumë e përmbarrimit, është mbështetur në dokumente të cilat rezultojnë të jenë të papërshtatshme për përmbarrim.

Gjatë vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbarrimor për borxhin që rrjedh nga fatura nr. 1048/AD e datës 16.11.2020 në vlerë prej 1,780.98 EUR ngase e njëjta i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në faturë

janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe faturat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes nënshkrimit, ndërsa fatura në fjalë nuk kontestohet as nga vet debitori në prapësimin e paraqitur.

Andaj, në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 991/22, datë 30.06.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.